



KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Sot në Komisionin Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit, kryetari Marko Bislimoski ka mbajtur mbledhje me Darko Dimovskin, kryetarin e Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë dhe Marjan Ristevskin, kryetarin e Konfederatës së Organizatave Sindikale të Maqedonisë.

Zgjerimi i listës së qytetarëve, të cilët janë të përfshirë me subvencione për varfërinë energjetike, me ata persona, të cilët janë goditur nga kriza shëndetësore, është njëra ndër opsionet, që mund të ndërmerren për t'i mbrojtur konsumatorët e ndjeshëm të goditur nga kriza e Kovidit - është propozim - aktvendimi i KRRE-së, për të cilin sindikatat theksuan se do ta rishikojnë në suaza të organeve dhe trupave të sindikatave dhe për të njëjtin do të vazhdojnë bisedat në mbledhjet në vijim, në të cilat do të ftohen edhe organizatat e qytetarëve.

"Bëhet fjalë për mekanizëm, i cili nënkupton zgjerim të përkohshëm të listës ekzistuese për kompensim për varfërinë energjetike, me persona, të cilët janë të goditur direkt nga kriza shëndetësore. Duhet t'u ndihmojmë më të varfërve, e jo t'i subvencionojmë më të pasurit - ky është edhe rekomandimi i përbashkët i KRRE-së dhe Sekretariatit të Komunitetit Energjetik. Institucionet duhet të rishikojnë se cilat propozim-aktvendime janë të zbatueshme: zgjerimi i listës së qytetarëve me subvencione, ulja e TVSH-së për energjinë elektrike të shpenzuar e kështu me rradhë. Tani fjalën e kanë Parlamenti dhe ministrinë kompetente si propozues të ndryshimeve në ligj*, theksoi kryetari Bislimoski në mbledhjen me liderët sindikalistë.

Bislimoski i informoi se Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit është vendosur në dispozicion me kapacitetin e tij të bëhet logjistikë në procesin e bisedimeve, të cilin sindikata do ta udhëheqë me qeverinë dhe me analiza dhe praktika adekuate ta argumentojë kërkesën për ndihmë për kategoritë më të ndjeshme.

16.9.2020

